

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"I&J FINANCE" SH.P.K.

*Në mbështetje të legjislacionit civil shqiptar dhe kryesisht në ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në ligjin Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" vendosëm hartimin e këtij statuti.*

*Në këtë statut:*

- "Ligji" është Ligji Nr. 9902, dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",
- "Statuti" është Statuti i shqërisë "I&J Finance" Sh.P.K.

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**

**Data e themelimit dhe emri, ortakët themelues**

1. Sot, më datë 6.10.2020, në Durrës, Republika e Shqipërisë, ne themeluesit, shtetas me zotësi të plotë për të vepruar, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin zyrtar I&J Finance SH.P.K. (shkurtimisht: I&J).

2. Ortakët themelues të shoqërisë janë:

- a. Znj. Jonilda Zeqiraj e lindur më datë 09 korrik të vitit 1995 në Kosinë (Përmet), Shqipëri, banuese në rrugën 'Dhimitër Kraja' lagja numër 13, në Durrës, Shqipëri, e identifikuar me anë të letërnjoftimit nr 032401470 dhe numër personal J55709075S
- b. Z. Igli Tartaraj, i lindur në datë 27 tetor të vitit 1992 në Cërrik (Elbasan), Shqipëri, banues në rrugën "17 Janari" lagja numër 10, në Durrës, Shqipëri, i identifikuar me anë të letërnjoftimit nr.033531465 dhe numër personal J21027008F.

**Neni 2**

**Objekti i veprimtarisë**

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Shërbime financiare dhe fiskale; shërbime të përpunimit të të dhënave financiare dhe kontabël për të tretë; shërbime në fushën e përpunimit të të dhënave financiare dhe kontabël (outsourcing back office) për shoqëritë tregtare dhe organizata të tjera jashtë Shqipërisë; këshillim/konsulencë ndërmarrjeje, shërbime administrative; shërbime marketingu, kërkime në treg dhe zhvillimi i sondazheve; shërbime imobiliare; shërbime në fushën e trajnimeve dhe kurseve në fushën ekonomisë dhe financës; dhënie e rekomandimeve për përmirësimin e biznesit dhe operacioneve të organizatave ose për aktivitete të tjera që nuk ndalohen me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

**Neni 4**

**Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Dhimitër Kraja, Lagja nr 13, nr pasurisë 25/94 vol.24. FQ. 11. ZK 8515 Durrës, Shqipëri (Albania).

2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

[ijsmartfinance@gmail.com](mailto:ijsmartfinance@gmail.com)

**KERU II**

**KAPITALI**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000.00 Lekë.

2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a. Ortaku themelues, Znj Jonilda Zeqiraj: zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 70 përqind të kapitalit themeltar të shoqërisë, e shprehur në vlerë monetare 7,000.00 Lekë;

b. Ortaku themelues, Z. Igli Tartaraj: zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 30 përqind të kapitalit themeltar të shoqërisë, e shprehur në vlerë monetare 3,000.00 Lekë.

**Neni 7**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit të shoqërisë.

2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



## STATUTI SHOQËRISË 'I&J FINANCE' SH.P.K

3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet, zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 8

#### Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "I&J FINANCE" Sh.P.K. dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
  - b) shitblerjes,
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie sipas legjisllacionit në fuqi.
4. Në rast të shitjeve të kuotave ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes së kuotës.
5. Në rast të trashëgimisë, trashëgimtarët e orakut do të shlyhet kuota brenda 6 (gjashtë) muajve nga kalimi i së drejtës së trashëgimisë.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

### Neni 9

#### Organi vendimmarrës

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

## STATUTI I SHOQËRISË "T&J FINANCE" S.H.P.K

- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- d. emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "e" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë;

5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme;

6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite;

### Neni 10

#### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet nje njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 11

#### Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 përqind të kuotave.



## STATUTI SHOQËRISË 'I&J FINANCE' SLLP.K

2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme e ortakëve duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë shumë se 2/3 e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme e ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
4. Asambleja drejtohet nga administratori i vetëm, nga kryetari i këshillit të administrimit ose nga administratori më i vjetër në moshë (në rastin e emërimit të disa administratorëve me kompetenca të ndara ose të përbashkëta). Në mungesë ose pamundësi të tyre, asambleja drejtohet nga personi i caktuar nga të pranishmit.
5. Asambleja mund të mbahet edhe në më shumë vende, me audio dhe/ose video të ndërlidhura dhe kjo në kushtet e mëposhtme:
  - a) kryetari dhe sekretari i asamblese janë të pranishëm në të njëjtin vend, i cili do të sigurojë formimin dhe nënshkrimin e procesverbalit;
  - b) që kryetari i mbledhjes të lejohet të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve të regullojë ecurinë e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
  - c) që të pranishmit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm në pikat në rendin e ditës;
6. Takimi do të mbahet në vendin ku kryetari do të jetë i pranishëm.

### Neni 12

#### Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin dhe shkarkimin ije likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve;
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - h) çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



### Neni 13

#### Përfashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme e ortakëve merr vendim për:

- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria
- d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

2. Nëse ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, nëse i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson, zbatohet pika 1 e këtij neni

### Neni 14

#### Administrimi i shoqërisë

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

2. Afati i emërimit, është 5 vite, me të drejtë ripërtëritjeje.

3. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

4. Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

5. Personi i përcaktuar në pikën 6 të këtij neni caktohet si administrator i parë i përkohshëm i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

6. Emërohet si administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar 'I&J FINANCE' Sh.P.K., z. Igli Tartaraj, i lindur më datë 27 tetor të vitit 1992 në Cërrik, Shqipëri, banues në rrugën "17 Janari", Durrës, Shqipëri, i identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. 033531465 dhe numër personal J21027008F.

### Neni 15

#### Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) përfaqësojnë shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë

- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese se përgjithshme të ortakëve për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhenat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB);
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme të ortakëve në lidhje me zbatimin politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;

Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, në rastet kur

- a) sipas bilancit vjetor apo raportere të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 per qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

4. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 16

### Përgjegjësitë e administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë
2. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja e përgjithshme e ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:



## STATUTI SHOQËRISË 'I&J FINANCE' SH.P.K

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesat apo dividendë pa vendimmarrjen e asamblesë së përgjithshme të ortakëve;
  - c) u shpëndan aktivet e shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi;
7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
8. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.





**KREU IV**

**VITI FINANCIAR DHE EKSPERTËT**

**Neni 17**

Viti financiar dhe eksperti kontabël i autorizuar

- 1) Viti financiar i shoqërisë fillon me datë 1 janar dhe përfundon më datë 31 dhjetor.
- 2) Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me datë 31 dhjetor të po atij viti.
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakëve, me shumicë të thjeshtë, ka të drejtë të emërojë një ekspert kontabël të autorizuar për të audituar pasqyrat financiare të shoqërisë.



**KREU V**

**PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në statut;
  - b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
  - e) me vendim të gjykatës;
2. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emërimin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri ne likuidim e sipër";
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të raste kur është nisur një procedurë falimentimi;
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët;
5. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes. Çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës përkatëse, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**

**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi dhe ndarja e saj**

Shoqëria mund të ndahet ose bashkohet sipas vendimit të mbledhjes të Asamblesë së Përgjegjshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX-të të ligjit Nr 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 20**

**Baza ligjore**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Nr 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare në të cilën ka vendndodhjen shoqëria. Në këtë rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.





**KREU VI**  
**DISPOZITAT TË VEÇANTA**

**Neni 22**

Ky statut hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**Neni 23**

Te gjitha dokumentet e lëshuara nga shoqëria do të përmbajnë emërtimin e shoqërisë I&J FINANCE Sh.p.k NIPT/NUIS dhe adresën e selisë qendrore.

**Neni 24**

Për çështje të tilla që nuk parashikohen në këtë statut, veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.



*Ortakët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
'I&J FINANCE' Sh.p.k*

**Jonilda Zeqiraj**



**Igli Tartaraj**



**Igli Tartaraj (administratori)**

